

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarve B. S., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, dhe R. G., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1641/2014 të datës 29.05.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Beqë Shala, të akuzuarve dhe të dëmtuarit, me datë 06.02.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit

**1. B. S.**, nga i ati H. dhe nëna S. e lindur K., i lindur me datën *data e lindjes...*, në fshatin R., Komuna e Gjakovës, tani jeton në Prizren, rruga ..., pa numër, ka të kryer shkollën e mesme, afarist, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. R. G.**, nga i ati J. dhe nëna G. e lindur G., i lindur me datën *data e lindjes...*, në Prizren, ku edhe tani jeton, rruga ..., nr...., ka të kryer shkollën e mesme, pensionist, i martuar, baba i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### J A N Ë F A J T O R

#### Se i pandehuri B. S.

**I.** Me datën 08.08.2014, rreth orës 20,00, në Prizren, në rrugën ..., para lokalit të quajtur “V. T.”, i shkaktonte lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezultoi me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshjeje në mes të pandehurit dhe të pandehurit R. G., në lidhje me kukullat e butikut dhe pas fjalosjes në mes tyre i pandehuri e sulmoi edhe fizikisht të pandehurin R. G., duke e goditur me grushta në fytyrë, me ç’ rast i shkaktonte lëndime të lehta trupore dhe atë, ndryshe të ineve të buta të buzëve të gojës, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor, të datës 01.10.2014,

Kësodore kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP -ës,

#### Se i pandehuri R. G.

**II.** Me datë, kohë dhe vende të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuzës, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshjeje në mes të pandehurit dhe të pandehurit B. S., në lidhje me kukullat e butikut dhe

pas fjalosjes në mes tyre i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin B. S., duke e rrokur për krahu dhe shtyrë,

Kësodore kanë kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-ës,

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 41, 43 par.1 pika 1.3, 46, 73, 74, 75, 76 dhe nenit 188 par.1 nën par.1.4 dhe 187 par.1 të KP-ës, te akuzuarve ju shqipton:

**Të akuzuarit të pare B. S.**

### **DENIM ME KUSHT**

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do e ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

**Të akuzuarit të dytë R. G.**

### **DENIM ME KUSHT**

Ashtu qe i vërteton dënimin me burg ne kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do e ekzekutohet ne afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër te re penale,

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare të paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe ate në emër të mendimit të ekspertit mjeko ligjor shumën prej 20,00 euro, si dhe të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësore secili veç e veç në shumën prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.2017/2014 të dates 31.05.2016, kundër të akuzuarve B. S., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, dhe R. G., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-ës

Prokurori i shtetit Elfete Purova, në fjalën e saj përfundimtare deklaron: qëndroj pranë aktakuzës PP.nr.2017/2014 e datë 31.05.2016, kundër të akuzuarve B. S., nga fshati R., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, dhe R. G., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-ës, dhe i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit, duke u bazuar në dispozitat e KP, meqenëse këtu të akuzuarit në shqyrtimin fillestar në mënyrë vullnetare e pranuan fajësinë për veprat penale si në aktakuzë, i propozoj gjykatës që ti merr parasysh të gjitha rrethanat cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, e si rrethanë lehtësuese ti merr

parasysh pranimin e fajësisë nga të akuzuarit në mënyrë vullnetare për veprat penale të cilat ju vihen në barë

I akuzuari i parë B. S., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranojë veprën penale cila më vihet në barë, e tëra që ka ndodhur ka qenë një moment nervoze, e cila nervozë ka eskaluar deri te një konflikt fizik, ku nuk kam mundur ta përmbaj vetën, dhe për këtë rast unë me këtu të dëmtuarin R. tani jemi pajtuar në ndërkohë, jemi në raporte të shëndosha, më vije keq për tërë që ka ndodhur, i kërkoj falje të dëmtuarit, pendohem thellë për veprimet e mia, andaj i propozoj gjykatës që të gjitha rrethana të cekura më lart, pranimin e fajësisë nga ana ime, si dhe rrethanat e mia familjare që jam person familjar, baba i tre fëmijëve, kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, si dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

I akuzuari i dytë R. G., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranojë veprën penale e cila më vihet në barë, unë me të dëmtuarin B. si theksoi edhe vet ai paraprakisht jemi pajtuar, tani jemi në raporte të shëndosha, andaj propozoj gjykatës që pranimin e fajësisë nga ana ime, sjelljen time korrekte, që kjo është hera e parë që kam ra në konflikt me ligjin, dhe premtimin tim që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, jam person familjar, baba i katër fëmijëve, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që ti merr si rrethana lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

### **Se i pandehuri B. S.**

**I.** Me datën 08.08.2014, rreth orës 20,00, në Prizren, në rrugën ..., para lokalit të quajtur “V. T.”, i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër, i cili rezulton me dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje në mes të pandehurit dhe të pandehurit R. G., në lidhje me kukullat e butikut dhe pas fjalosjes në mes tyre i pandehuri e sulmon edhe fizikisht të pandehurin R. G., duke e goditur me grushta në fytyrë, me ç’ rast i shkakton lëndime të lehta trupore dhe atë, ndrydhje të ineve të buta të buzëve të gojës, lëndime të përshkruara më për së afërmi në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor, të datës 01.10.2014,

### **Se i pandehuri R. G.**

**II.** Me datë, kohë dhe vende të njëjtë të përshkruar si në dispozitivin e parë të kësaj aktakuzës, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje në mes të pandehurit dhe të pandehurit B. S., në lidhje me kukullat e butikut dhe pas fjalosjes në mes tyre i pandehuri e sulmon fizikisht të pandehurin B. S., duke e rrokur për krahu dhe shtyrë,

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajin, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila ju vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 248 të KPP-ës dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarve, dhe ate në veprimet e të akuzuarit të pare B. S. formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nën par.1.4 të KP-ës, dhe në veprimet e të akuzuarit të dytë R. G., formohen të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-ës, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësin e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve, pendimi i thellë i të akuzuarve, sjellja korrekte e të akuzuarve pas kryerjes së veprës penale, moshë e të akuzuarve, më herët nuk kanë qenë të dënuar, çka nënkupton se nuk kanë ardhur ndesh me rregullat pozitive, po ashtu konform nenit 74 gjykata mori parasysh edhe rrethanat personale të akuzuarve dhe karakterin e tyre, moshën e të njejtve, bashkpunimin e përgjithshëm me gjykatën, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur si dhe sjelljen e të akuzuarve pas konfliktit, janë persona familjar dhe ate i akuzuari i pare B. S. është baba i tre fëmijëve, si dhe i akuzuari i dytë R. G., baba i katër fëmijëve, andaj gjykata ju shqiptonë dënimin me burgim secilit veç e veç në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajëve, cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishëmrisë të këtij aktgjykimi, nëse të akuzuarit nuk kryejnë vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 454 të KPP.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1144/2016 me datë 06.02.2017**

**Procesmbajtesja**  
**Naxhis Sharani,**

**Gjyqtari,**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakenaqr ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së njejtës, Gjykates së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.